

V E N D I M
Nr.577, datë 15.9.1998

**PËR RIVENDOSJEN E RENDIT KUSHTETUES TË CËNUAR NGA GRUPE TË
ARMATOSURA**

Këshilli i Ministrave, pasi diskutoi me përgjegjësi ngjarjet e ndodhura gjatë datave 13 dhe 14 shtator të vitit 1998, me detyrimin e vet për mbrojtjen e rendit kushtetues, në mbështetje të kompetencave që burojnë nga ligji nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”

V E N D O S I:

1. Të konsiderojë grusht shteti ngjarjet e datës 14 shtator 1998, nëpërmjet të cilave me veprime të organizuara, të dhunshme dhe të armatosura u realizua pushtimi me forcë dhe plaçkitja e ndërtesave të selive të Kuvendit Popullor, të Kryesisë së Kuvendit Popullor, të Këshillit të Ministrave, të Gjykatës Kushtetuese, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të Ministrisë së Drejtësisë, të Ministrisë së Financave dhe të Radiotelevizionit Shqiptar, si dhe goditja me armë e Ministrisë së Rendit Publik të nxitura, të organizuara dhe të drejtuara nga Sali Berisha dhe bashkëpunëtorët e tij.

2. Të eliminojë në mënyrë përfundimtare, ndërmjet strukturave përkatëse ligjore të shtetit, të gjitha tentativat dhe veprimet që vazhdojnë të synojnë përmbysjen me anë të dhunës dhe armëve, të rendit kushtetues dhe të institucioneve legjitime të shtetit.

3. Ministria e Rendit Publik të vërë në dispozicion forcat e saj dhe t'i përgjigjet me efikasitet kërkesave të organeve të prokurorisë për ndjekjen penale të të gjithë personave organizatorë, ekzekutorë, shtytës dhe ndihmës, pjesëmarrës në këtë grusht shteti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano